



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1708 Prot

Tiranë, më 10.12.2019

**V E N D I M**

Nr.158, datë 10.12.2019

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Kukës, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kukës,

Vërej se :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Kukës.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Kukës, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 8, datë 22.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, “Për miratimin e strukturës, organikës, së Bashkisë Kukës, për vitin 2019”, në zbatim të vendimit nr. 82, datë 04.01.2019, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës, për vitin 2019”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Kukës së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **113** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **2** pozicione të nivelit të lartë drejtues, **15** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **17** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **79** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Kukës, Komisioneri ka konstatuar pozicione pune, të cilat për nga emërtesa konsiderohen si pozicione të shërbimit civil, për faktin se në strukturë shoqërohen me emërtesën “*Specialist*” ose “*Inspektor*”. Rezulton se, këto pozicione, pavarësisht emërtesës, janë trajtuar nga njësia përgjegjëse si funksione administrative, jashtë shërbimit civil, nisur nga kompetencat dhe detyrat funksionale që ato kryejnë, si dhe kategoria e pagës së aplikuar për këto pozicione.

Në këto rrethana, në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, me miratimin e strukturës së ardhshme të institucionit, pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksione administrative dhe nuk ushtrojnë autoritet publik, nuk duhet të shoqërohen me emërtesën “*Specialist*” ose “*Inspektor*”, me qëllim diferencimin e tyre nga pozicionet e shërbimit civil.

Në vijim të analizës së strukturës organizative të Bashkisë Kukës, Komisioneri konstaton disa parregullsi në mënyrën e organizimit të disa prej njësive organizative të institucionit, të cilat do të analizohen në vijim:

**Së pari**, rezulton se në disa raste nuk është respektuar standardi numerik për krijimin e njësive organizative. Konkretisht vërehet se, në strukturën e Bashkisë Kukës, rezultojnë njësi organizative me emërtesën “*Drejtori*”, të cilat kanë një numër maksimal prej dy punonjësish në përbërje të tyre, fakt që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, i cili përcakton se një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës;

**Së dyti**, evidentohen raste kur njësia përgjegjëse e Bashkisë Kukës nuk ka treguar kujdes në identifikimin e kompetencave kryesore, me qëllim krijimin e njësive organizative me pozicione pune, që kryejnë funksione dhe detyra të ngjashme dhe të së njëjtës fushë.

Për këtë arsye, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturës së ardhshme të institucionit, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me drejtuesit e njësive organizative duhet të tregojë kujdes në krijimin e një strukture efektive, nëpërmjet zbatimit të parimit të unitetit dhe hierarkisë administrative, të llogaridhënies si dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, duke u orientuar në përcaktimet e ligjit nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”. Njëkohësisht, në zbatim të dispozitave të po këtij ligji, njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes në analizën dhe përcaktimin e detyrave, kompetencave dhe funksioneve që kryejnë pozicionet e punës me qëllim grupimin e pozicioneve me funksione të ngjashme në të njëjtën njësi organizative, si sektorë dhe/ose drejtori.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se, **38** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **75** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur dhe nuk ka pozicione që aktualisht janë të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*, Sekretar i Përgjithshëm, në Bashkinë Kukës, emëruar me urdhrin nr. 148, datë 06.09.2019;
2. \*\*\*\*\*, “*Specialist i shpenzimeve*”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 203, datë 19.09.2019;
3. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 91, datë 30.08.2019;
4. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 166, datë 11.09.2019;
5. \*\*\*\*\*, “*Specialist i administrimit të rrjetit dhe website*”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Teknologjisë së Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 156, datë 09.09.2019;
6. \*\*\*\*\*, “*Shef i Njesisë për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj*”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Teknologjisë së Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 134, datë 04.09.2019;

7. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 105, datë 30.08.2019;
8. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale”, emëruar me urdhrin nr. 142, datë 06.09.2019;
9. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore dhe Projekteve, emëruar me urdhrin nr. 217, datë 23.09.2019;
10. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Arsimit, QKF dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me urdhrin nr. 150, datë 06.09.2019;
11. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 82, datë 30.08.2019;
12. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 115, datë 02.09.2019;
13. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Bicaq, emëruar me urdhrin nr. 89, datë 30.08.2019;
14. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 88, datë 30.08.2019;
15. \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm*”, emëruar me urdhrin nr. 141, datë 04.09.2019;
16. \*\*\*\*\*, “*Drejtor i Përgjithshëm*”, emëruar me urdhrin nr. 549, datë 02.11.2016;
17. \*\*\*\*\*, Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 463, datë 31.12.2018;
18. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 1, datë 04.01.2018;
19. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pronave publike dhe menaxhimit*”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 65, datë 01.03.2017;
20. \*\*\*\*\*, “*Specialist i kontrollit të territorit*”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 15/1, datë 01.02.2017;
21. \*\*\*\*\*, “*Specialist i kontrollit të territorit*”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 126, datë 13.03.2018;
22. \*\*\*\*\*, “*Specialist i kontrollit të territorit*”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 04.02.2019;
23. \*\*\*\*\*, “*Specialist i kontrollit të territorit*”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 442, datë 01.09.2016;

24. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Borxhit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 178, datë 21.04.2017;
25. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Borxhit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 318, datë 31.08.2018;
26. \*\*\*\*\*, “*Specialist informacioni dhe pritje*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 459, datë 28.12.2018;
27. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Njësinë për Koordinimin e Integritit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 241, datë 07.06.2019;
28. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 101/1, datë 01.09.2015;
29. \*\*\*\*\*, “*Specialist i menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës*”, në Sektorin e Pronave dhe Hartografisë, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 126, datë 17.03.2017;
30. \*\*\*\*\*, “*Specialist i auditit të brendshëm*”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 318, datë 15.10.2019;
31. \*\*\*\*\*, “*Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 414/1, datë 05.11.2018;
32. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 161, datë 19.04.2017;
33. \*\*\*\*\*, “*Administrator NE*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 257, datë 05.07.2018 ;
34. \*\*\*\*\*, “*Specialist për zhvillimin e politikave rinore*”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore, Projekteve dhe Integritit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 208, datë 22.05.2017;
35. \*\*\*\*\*, “*Specialist i bashkëpunimit dhe koordinimit*”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore, Projekteve dhe Integritit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 161, datë 18.03.2016;
36. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 116, datë 02.09.2019;
37. \*\*\*\*\*, “*Specialist për projektet e investimeve dhe shërbimeve*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 63/1, datë 01.03.2017;
38. \*\*\*\*\*, “*Specialist për dhënie licencave*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 425, datë 15.11.2018;
39. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 122, datë 15.03.2017;

40. \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndriçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 97, datë 31.08.2015;
41. \*\*\*\*\*, “*Specialist mjedisi*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndriçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 01.02.2018;
42. \*\*\*\*\*, “*Specialist i dekorit dhe ndriçimit*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndriçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 26/2, datë 01.02.2019;
43. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, emëruar me urdhrin nr. 189, datë 15.05.2018;
44. \*\*\*\*\*, “*Inspektor kontrolli për sigurinë ushqimore*”, në Drejtorinë e Arsimit Parashkollor, QKF dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me urdhrin nr. 53, datë 01.02.2018;
45. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 214, datë 29.05.2017;
46. \*\*\*\*\*, “*Specialist i shërbimeve bujqësore*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 69, datë 01.03.2017;
47. \*\*\*\*\*, “*Specialist i programimit dhe vlerësimit të politikave rurale*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 70, datë 01.03.2017;
48. \*\*\*\*\*, “*Specialist i programimit dhe vlerësimit të politikave rurale*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 207, datë 20.09.2019;
49. \*\*\*\*\*, “*Specialist i shërbimeve frutikulturë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 120, datë 15.03.2017;
50. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, emëruar me urdhrin nr. 85, datë 30.08.2019;
51. \*\*\*\*\*, “*Specialist i hartimit të projekteve*”, , në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, emëruar me urdhrin nr. 160, datë 08.04.2019;
52. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Malzi, emëruar me urdhrin nr. 49/1, datë 01.02.2018;
53. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Bicaq, emëruar me urdhrin nr. 195, datë 28.10.2015;
54. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Ujmisht, emëruar me urdhrin nr. 147, datë 03.04.2018;
55. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Tërthore, emëruar me urdhrin nr. 58/2, datë 01.02.2018;
56. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Shtiçen, emëruar me urdhrin nr. 63/2, datë 01.02.2018;

57. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Zapod, emëruar me urdhrin nr. 66/2, datë 01.02.2018;
58. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Shishtavec, emëruar me urdhrin nr. 203, datë 28.10.2015;
59. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Topojan, emëruar me urdhrin nr. 190, datë 28.10.2015;
60. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Bushtricë, emëruar me urdhrin nr. 65/1, datë 01.02.2018;
61. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Grykë-Çaje, emëruar me urdhrin nr. 229, datë 28.10.2015;
62. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kalis, emëruar me urdhrin nr. 85, datë 03.02.2016;
63. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Surroj, emëruar me urdhrin nr. 226/1, datë 28.10.2015;
64. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Arren, emëruar me urdhrin nr. 156, datë 05.04.2019;
65. \*\*\*\*\*, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kolsh, emëruar me urdhrin nr. 32, datë 01.02.2018;
66. \*\*\*\*\*, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Rugëve Rurale, emëruar me urdhrin nr. 3, datë 08.01.2018;
67. \*\*\*\*\*, “*Specialist i hartimit të projekteve*”, në Drejtorinë e Rugëve Rurale, emëruar me urdhrin nr. 435, datë 31.08.2016;
68. \*\*\*\*\*, “*Specialist i administrimit të pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 68, datë 01.03.2017;
69. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 330, datë 13.06.2016;
70. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 06.03.2017;
71. \*\*\*\*\*, “*Specialist i kadastrës pyjore*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 313, datë 13.06.2016;
72. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 30, datë 01.02.2018;
73. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 41, datë 01.02.2018;
74. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 100, datë 08.03.2019;
75. \*\*\*\*\*, “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 212, datë 24.05.2018.

Komisioneri konstaton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi në bazë të neneve 22 – 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të

ndryshuar, pranimet në shërbimin civil duhen bërë, duke respektuar detyrimisht një procedurë të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është absolutisht i pavlefshëm. Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, për pozicionet e nivelit ekzekutiv, është theksuar shprehimisht edhe në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Kukës, duhet të evidentojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të konstatojë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, shoqëruar kjo me përcaktimin e masave për rregullimin e pasojave duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, shpalljen e këtyre pozicione vakante për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Në kushtet kur, pranë këtij institucioni është një numër relativisht i lartë i pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, duhen të mbahen parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të realizuar konkurrimet në grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III,



“Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kukës, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **75** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:
  - ✓ \*\*\*\*\* , Sekretar i Përgjithshëm, në Bashkinë Kukës, emëruar me urdhrin nr. 148, datë 06.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i shpenzimeve”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 203, datë 19.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 91, datë 30.08.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 166, datë 11.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i administrimit të rrjetit dhe website”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Teknologjisë së Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 156, datë 09.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Shef i Njesisë për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve Publike dhe Teknologjisë së Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 134, datë 04.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 105, datë 30.08.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale”, emëruar me urdhrin nr. 142, datë 06.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore dhe Projekteve, emëruar me urdhrin nr. 217, datë 23.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë e Arsimit, QKF dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me urdhrin nr. 150, datë 06.09.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 82, datë 30.08.2019;
  - ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i pyjeve”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 115, datë 02.09.2019;

- ✓ \*\*\*\*\* , “Administrator i Ndhmës Ekonomike”, në Njësinë Administrative Bicaj, emëruar me urdhrin nr. 89, datë 30.08.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 88, datë 30.08.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm”, emëruar me urdhrin nr. 141, datë 04.09.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Drejtor i Përgjithshëm”, emëruar me urdhrin nr. 549, datë 02.11.2016;
- ✓ \*\*\*\*\* , Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 463, datë 31.12.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 1, datë 04.01.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i pronave publike dhe menaxhimit”, në Sektorin e Shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 65, datë 01.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i kontrollit të territorit”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 15/1, datë 01.02.2017;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i kontrollit të territorit”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 126, datë 13.03.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i kontrollit të territorit”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 04.02.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist i kontrollit të territorit”, në Sektorin e Regjistrimit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 442, datë 01.09.2016;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Borxhit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 178, datë 21.04.2017;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Borxhit, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 318, datë 31.08.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist informacioni dhe pritje”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 459, datë 28.12.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Njësinë për Koordinimin e Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 241, datë 07.06.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 101/1, datë 01.09.2015;

- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës*”, në Sektorin e Pronave dhe Hartografisë, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 126, datë 17.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i auditit të brendshëm*”, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 318, datë 15.10.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 414/1, datë 05.11.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 161, datë 19.04.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator NE*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 257, datë 05.07.2018 ;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist për zhvillimin e politikave rinore*”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore, Projekteve dhe Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 208, datë 22.05.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i bashkëpunimit dhe koordinimit*”, në Drejtorinë e Koordinimit të Politikave Rinore, Projekteve dhe Integritimit Evropian, emëruar me urdhrin nr. 161, datë 18.03.2016;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 116, datë 02.09.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist për projektet e investimeve dhe shërbimeve*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 63/1, datë 01.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist për dhënien e licencave*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 425, datë 15.11.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 122, datë 15.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndrçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 97, datë 31.08.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist mjedisi*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndrçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 31, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i dekorit dhe ndrçimit*”, në Sektorin e Gjelbërimit, Dekorit dhe Ndrçimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 26/2, datë 01.02.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, emëruar me urdhrin nr. 189, datë 15.05.2018;

- ✓ \*\*\*\*\*; “*Inspektor kontrolli për sigurinë ushqimore*”, në Drejtorinë e Arsimit Parashkollor, QKF dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me urdhrin nr. 53, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 214, datë 29.05.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i shërbimeve bujqësore*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 69, datë 01.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i programimit dhe vlerësimit të politikave rurale*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 70, datë 01.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i programimit dhe vlerësimit të politikave rurale*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 207, datë 20.09.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i shërbimeve frutikulturë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, emëruar me urdhrin nr. 120, datë 15.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, emëruar me urdhrin nr. 85, datë 30.08.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Specialist i hartimit të projekteve*”, ”, në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, emëruar me urdhrin nr. 160, datë 08.04.2019;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Malzi, emëruar me urdhrin nr. 49/1, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Bicaçaj, emëruar me urdhrin nr. 195, datë 28.10.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Ujmisht, emëruar me urdhrin nr. 147, datë 03.04.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Tërthore, emëruar me urdhrin nr. 58/2, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Shtiçen, emëruar me urdhrin nr. 63/2, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Zapod, emëruar me urdhrin nr. 66/2, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Shishtavec, emëruar me urdhrin nr. 203, datë 28.10.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Topojan, emëruar me urdhrin nr. 190, datë 28.10.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Bushtricë, emëruar me urdhrin nr. 65/1, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Grykë-Çaje, emëruar me urdhrin nr. 229, datë 28.10.2015;
- ✓ \*\*\*\*\*; “*Administrator i Ndihmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kalis, emëruar me urdhrin nr. 85, datë 03.02.2016;

- ✓ \*\*\*\*\* , “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Surroj, emëruar me urdhrin nr. 226/1, datë 28.10.2015;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Arren, emëruar me urdhrin nr. 156, datë 05.04.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Kolsh, emëruar me urdhrin nr. 32, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Rrugëve Rurale, emëruar me urdhrin nr. 3, datë 08.01.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i hartimit të projekteve*”, në Drejtorinë e Rrugëve Rurale, emëruar me urdhrin nr. 435, datë 31.08.2016;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i administrimit të pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 68, datë 01.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 330, datë 13.06.2016;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 06.03.2017;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i kadastrës pyjore*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 313, datë 13.06.2016;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 30, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 41, datë 01.02.2018;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 100, datë 08.03.2019;
- ✓ \*\*\*\*\* , “*Specialist i pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 212, datë 24.05.2018.

dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin.

2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat rezultojnë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
3. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e nivelit ekzekutiv të realizojë procedurat e konkurrimit të hapur, duke mbajtur parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me qëllim realizimin e

konkurrimeve për grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë deri në shkurt të vitit 2020, planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kukës, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:
  - ✓ Të evitohet përdorimi i emërtesave “*Specialist*” ose “*Inspektor*”, për pozicione pune të cilat nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil;
  - ✓ Të krijojë njësi organizative në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, duke respektuar standardin numerik, si dhe parimin e unitetit dhe hierarkisë administrative, të llogaridhënies si dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, me qëllim grupimin e pozicioneve me funksione të ngjashme në të njëjtën njësi organizative, si sektorë dhe/ose drejtori.
6. Të përmbyllet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 236, datë 105.12.2017, të Komisionerit, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kukës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur

mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kukës, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kukës, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Kukës. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kukës të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**